IKTK
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT

Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore

GJURMA MUJORE

Qershor 2026

Zbulohet një kompleks termal romak në Zgjanë, Lushnje

Atelieja e trajnimit "Mirëmbajtja e mozaikut të nefit verior të Bazilikës B", Bylis-Klos

Restaurim, Kulla e Turanit

Teqeja e Koshtanit drejt një faze të re restaurimi dhe konservimi

Inspektim në terren; Kisha e Shën Mërisë, Serjanë, Përmet

Samiti i Trashëgimisë Digjitale, Qipro

Bashkëpunim Shqipëri–SHBA për forcimin e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore

Muzeu Arkeologjik i Korçës: nga restaurimi drejt një eksperience të re kulturore

Butrinti zbulon mozaikët

Botimi nr. 06
IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Zbulohet një kompleks termal romak në Zgjanë, Lushnje

Specialistët e IKTK-së, në bashkëpunim me Departamentin e Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë dhe Bashkinë Lushnje, kanë zbuluar një sit të ri arkeologjik në fshatin Zgjanë.

Gërmimet kanë nxjerrë në dritë gjurmët e një kompleksi termal të periudhës romake dhe ambienteve të lidhura me të, një nga zbulimet më të rëndësishme arkeologjike në zonën e Lushnjes në dekadat e fundit.

Kërkimet vijojnë dhe pritet të sjellin të dhëna të reja mbi historinë e zonës, duke shtuar potencialisht një monument të ri kulture dhe një atraksion të rëndësishëm për turizmin kulturor.



IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.











IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Atelieja e trajnimit “Mirëmbajtja e mozaikut të nefit verior të Bazilikës B”, Bylis-Klos

Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, në bashkëpunim me partnerët universitarë dhe institucionet lokale, zhvilloi në Parkun Arkeologjik Kombëtar Bylis-Klos atelienë e trajnimit “Mirëmbajtja e mozaikut të nefit verior të Bazilikës B”.

Ndërhyrjet përfshinë dokumentimin e gjendjes së konservimit, konsolidimin e nënshtresave, rivendosjen e teserave të shkëputura, bordurimin dhe pastrimin e sipërfaqes së mozaikut.

Projekti shërbeu gjithashtu si trajnim praktik për specialistët e rinj të DRTK-ve dhe studentët e Departamentit të Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore, duke kontribuar në ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe në formimin e brezit të ri të profesionistëve të fushës.



IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.











IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Restaurim, Kulla e Turanit

Vijojnë punimet për restaurimin dhe konsolidimin e Kullës së Turanit, një monument me rëndësi të veçantë historike dhe arkitektonike, i përfshirë në listën e objekteve në risk të DRTK Korçë. Ndërhyrjet, të financuara nga fondi i MTKS për rastet emergjente, përfshijnë konsolidimin e muraturave, trajtimin e çarjeve, restaurimin e kupolës dhe çatisë, si dhe përmirësimin e mbrojtjes nga lagështira.

Krahas shpëtimit dhe stabilizimit të monumentit, synohet edhe rivitalizimi i tij si pjesë e itinerareve turistike dhe kulturore të zonës, duke ruajtur autenticitetin dhe vlerat e tij historike për brezat e ardhshëm.









IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Teqeja e Koshtanit drejt një faze të re restaurimi dhe konservimi

Kanë nisur punimet për restaurimin dhe konservimin e Teqesë së Koshtanit, Monument Kulture i Kategorisë I dhe një nga qendrat më të rëndësishme të bektashizmit në jug të Shqipërisë. Projekti, i hartuar nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore dhe Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Gjirokastër, parashikon konsolidimin strukturor të objektit, restaurimin e çatisë me rrasa guri, rikuperimin e elementeve drusore origjinale, restaurimin e dyshemeve dhe tavaneve, si dhe trajtimin e fasadave për mbrojtjen afatgjatë të monumentit.

Punimet realizohen me financimin e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore. E themeluar në vitin 1807, Teqeja e Koshtanit ka një rëndësi të veçantë historike dhe shpirtërore, ndërsa në vitin 1908 aty u hap edhe shkolla e parë shqipe për krahinën e Tepelenës.







IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Inspektim në terren; Kisha e Shën Mërisë, Serjanë, Përmet

Kisha e Shën Mërisë në Serjanë, Përmet, është ndalesa e radhës në punën e specialistëve të IKTK-së për dokumentimin dhe përgatitjen e projektit të restaurimit.

Gjatë inspektimeve në terren u dokumentua gjendja e monumentit, u evidentuan problematikat e konservimit dhe u krye vlerësimi i nevojave për ndërhyrjet restauruese.

Një tjetër hap konkret drejt ruajtjes dhe përcjelljes së vlerave të trashëgimisë sonë kulturore te brezat e ardhshëm.









IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Samiti i Trashëgimisë Digjitale, Qipro

U mbajt në Qipro Samiti i Trashëgimisë Digjitale (Digital Heritage Summit), i organizuar nga Katedra e UNESCO-s për Trashëgiminë Kulturore Digjitale në Universitetin e Teknologjisë të Qipros, në bashkëpunim me iniciativën Europeana dhe DG CONNECT të Komisionit Europian dhe nën kujdesin e Presidencës së Këshillit Qipro-BE.
Ky aktivitet përfaqësoi një moment të rëndësishëm për sektorin e trashëgimisë kulturore në nivel europian, duke bashkuar palët kryesore të interesuara për të adresuar rolin e digjitalizimit, përmirësimin e aksesit, përdorimit dhe ripërdorimit të trashëgimisë kulturore dhe sfidat në rritje të trafikimit të paligjshëm dhe shkatërrimit të trashëgimisë kulturore.

Programi përfshinte:

- Tryezë të rrumbullakët me temën: Pse të digjitalizohet e kaluara dhe ndikimi i saj në jetën tonë të përditshme ?
- Hackathon Pan-Europian Hackit!4EU mbi trashëgiminë kulturore 3D
- Tryezë të rrumbullakët me temën: Trafikimi i paligjshëm dhe shkatërrimi i trashëgimisë kulturore, duke përfshirë diskutimin mbi krijimin e mundshëm të një qendre kompetence të BE-së.

IKTK mori pjesë në këtë samit me anë të Sektorit të Platformës Digjitale për Trashëgiminë Kulturore duke e parë atë si një mundësi e vlefshme për të shkëmbyer ide, për të eksploruar qasje të reja dhe për të krijuar ndërtimin e lidhjeve me komunitetin.







Fotografitë realizuar nga: Pambos Charalambous

IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Bashkëpunim Shqipëri–SHBA për forcimin e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore

Gjatë takimit mes përfaqësuesve të IKTK-së, IKRTK-së, Ambasadës së SHBA-së në Shqipëri dhe Z. Andrew Zonderman, Oficer i Marrëdhënieve me Jashtë pranë Qendrës së Trashëgimisë Kulturore të ECA-s, u diskutua mbi bashkëpunimin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe shkëmbimin e ekspertizës, në kuadër të procesit të rinovimit të Marrëveshjes për materialet arkeologjike dhe etnografike.

U trajtuan gjithashtu çështje që lidhen me dokumentimin dhe regjistrimin e pasurive kulturore, monitorimin e gërmimeve arkeologjike dhe përdorimin e teknologjive të reja për ruajtjen dhe menaxhimin e tyre, duke rikonfirmuar rëndësinë e bashkëpunimit institucional dhe ndërkombëtar në këtë fushë.







IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Muzeu Arkeologjik i Korçës: nga restaurimi drejt një eksperience të re kulturore

Kanë përfunduar punimet restauruese në godinën e Muzeut Arkeologjik të Korçës, ish-banesa historike e Fani Pjastos, një nga objektet me vlera të veçanta të trashëgimisë kulturore të qytetit.

Si një bashkëpunim mes Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Korçë dhe Bashkisë Korçë, po punohet për hapat e mëtejshëm drejt muzealizimit dhe rijetëzimit të kësaj hapësire, si pjesë e një vizioni më të gjerë për krijimin e një rrjeti të integruar kulturor e muzeor që promovon historinë, identitetin lokal dhe eksperiencat autentike të zonës.









IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.

Butrinti zbulon mozaikët

Specialistët e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore morën pjesë në procesin e hapjes, dokumentimit dhe konservimit të disa prej mozaikëve më të çmuar në Parkun Kombëtar të Butrintit, në kuadër të nismës së ndërmarrë nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit për sezonin turistik veror 2026 dhe programit të konservimit arkeologjik.

Nëpërmjet kësaj nisme u realizua zbulimi i këtyre mozaikëve për publikun, ndërsa specialistët vijojnë punën për dokumentimin dhe ndërhyrjet konservuese që garantojnë ruajtjen e tyre.
Këto ndërhyrje synojnë mbrojtjen afatgjatë të kësaj trashëgimie të vyer kulturore, duke mundësuar njëkohësisht që vizitorët të njihen më nga afër me vlerat e jashtëzakonshme të Butrintit dhe me detaje artistike që kanë mbijetuar ndër shekuj.





IKTK ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe arkeologjike, duke përfshirë kërkimin, studimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen dhe promovimin e saj, si dhe koordinimin e proceseve të arkeologjisë parandaluese dhe të shpëtimit në Republikën e Shqipërisë.